

REZULTATE POZITIVE FINANCIARE, NË PËRPUTHJE ME STRATEGJINË E RRIJTJES SË AKTIVITETIT

Dritan Musatafa, Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Bank, thotë për revistën "Monitor", se banka e tij u rrit edhe për vitin 2020 me një normë rritje më të lartë se mesatarja e sistemit bankar. Megjithëse disa degë të ekonomisë, kryesisht tregtia dhe shërbimet u prekën ndjeshëm nga pasojat e krizës, z.Mustafa thotë se Tirana Bank nuk pret rritje shqetësuese të raportit të kredive me probleme. Sipas tij, Tirana Bank vijon t'i përmbahet objektivit strategjik të rritjes së mëtejshme të aktivitetit edhe gjatë vitit 2021, përfshi këtu edhe zgjerimin e aktivitetit në Kosovë, nëpërmjet një zyre përfaqësimi.

**Si do ta vlerësonit ecurinë e bankës suaj në vitin 2020?
Cilat do të veçorit si arritjet me domethënëse dhe sfidat kryesore në aktivitetin tuaj?**

Tirana Bank, një nga bankat kryesore dhe me një prani të gjatë dhe të rëndësishme në tregun lokal, vijon të zgjerojë aktivitetin, referuar bazës së gjerë të klientëve, si dhe sinergjive komerciale të zhvillimit, me partnerët dhe bashkëpunëtorët e Bankës sonë dhe të Grupit Balfin, grupi ekonomik ku bëjmë pjesë. Në vitin 2020, në përputhje me strategjinë e zhvillimit, Tirana Bank realizoi një performancë të shëndetshme në drejtim të rritjes organike të aktivitetit. Kemi rikonfirmuar praninë tonë aktive në tregun lokal, duke ofruar mbështetje dinamike për zhvillimin e ekonomisë lokale, me fokus tek individët dhe subjektet e biznesit.

Referuar indikatorëve kryesorë komercialë dhe financiarë, trendi rritës vijon që nga viti paraardhës (që përkon me ndryshimin e strukturës aksionere të Bankës), me një normë rritje më të lartë se mesatarja e sistemit bankar. Kam kënaqësinë t'ju informoj se Tirana Bank raporton rritje vjetore të qëndrueshme të Totalit të Aseteve/Bilancit +9% (përkundrejt +5.5% të sistemit bankar), rritje të nivelit të depozitave të klientëve +12% (përkundrejt +6% të sistemit bankar), rritje të portofolit të kredive/investimeve +19% (përkundrejt +4% të sistemit bankar). Viojmë të trajtojmë me shumë vëmendje



**DRITAN
MUSTAFA**

**Drejtor i Përgjithshëm
Ekzekutiv i Tirana Bank**

uljen e nivelit të kredive problematike, duke realizuar zvogëlim prej -17% të portofolit përkatës, duke qenë tashmë brenda normave të sektorit bankar. E konsiderojmë shumë të rëndësishme që Banka vijon të raportojë rezultate pozitive financiare të qëndrueshme. Indikatorët e likuiditetit dhe të kapitalit mbeten në nivele të konsoliduara, që ofrojnë mundësinë e një zgjerimi të mëtejshëm dhe të qëndrueshëm të aktivitetit tonë bankar.

Viti 2020 u karakterizua nga zhvillime jo të zakonshme, kryesisht për shkak të pandemisë, por edhe si rezultat i pasojave të tërmetit. Të gjithë aktorët ekonomikë janë përballur me sfida të veçanta, të cilat qartësisht kanë ndikuar në jetën ekonomike të vendit, nivelin e investimeve dhe të remitançave, sjelljen dhe kërkesën konsumatore për produkte dhe shërbime, lëvizshmërinë dhe dinamikën e biznesit, etj. Gjithsesi, koordinimi i hapave midis Qeverisë Shqiptare, Bankës së Shqipërisë dhe Sistemit Bankar, në drejtim të mbështetjes financiare të ofruar, lehtësimin e përkohshëm të ngarkesës financiare për kredimarr

rësit (në përputhje me moratoriumet e kredive), së bashku me mundësitë për ristrukturim të detyrimeve të kredive (në përputhje me lehtësimet e ofruara në zbatim të kuadrit rregullator), vlerësojmë që kanë mundësuar përbalimin më lehtë të vështirësive financiare të shkaktuara nga pandemia, garantimin e jetës ekonomike, si dhe mbështetjen për rivitalizim gradual të konsumit dhe të investimeve.

Në këndvështrimin tuaj, cilat ishin ndryshimet më të rëndësishme që solli pandemia në mënyrën e të operuarit, ose në modelin e biznesit të bankave tregtare?

Pavarësisht sfidave të diktuar nga pandemia në vitin 2020, të cilat vijnë edhe aktualisht, në vlerësimin tim, sistemi bankar u përshtat shumë shpejt me situatën, për të ruajtur nivelin e shërbimit dhe mbështetjen ndaj klientëve. Ky është një indikator i rëndësishëm, që sistemi bankar mbetet sektori më i rregulluar dhe dinamik, si dhe një aktor mjaft i rëndësishëm në qëndrueshmërinë e zhvillimit të ekonomisë lokale.

Masat organizative, referuar kryesisht të punuarit të një pjese të stafit kushtet e shtëpisë, duke siguruar infrastrukturën përkatëse për ta mundësuar këtë formë të re pune, ishin një nga risitë që diktoi pandemia. Referuar sektorit bankar në tërësi, kjo formë e re e organizimit të punës mund të vijojë edhe në afat të mesëm dhe të gjatë, në varësi të tendencave për optimizim të infrastrukturës së punës dhe kostove logjistike, si dhe shkallës së përdorimit të teknologjisë në aspekte të ndryshme të aktivitetit.

Në vitin 2020 ka pasur një rritje të ndjeshme të përdorimit nga ana e klientëve të shërbimeve financiare, nëpërmjet kanaleve alternative (p.sh.: transaksione në ATM, karta debiti/kreditit, si dhe në platforma dixhitale, etj.). Transaksionet me karta debiti/kreditit të klientëve të Tirana Bank shënuan rritje rreth +15% krahasuar me 2019, si një metodë e preferuar pagese nga klientët për të zvogëluar kontaktin me njerëzit dhe paranë fizike, për çështje sigurie shëndeti.



Vlerësojmë se kjo tendencë në rritje e përdorimit të kanaleve alternative do të vijojë edhe në të ardhmen, jo vetëm për shkak të efekteve të pandemisë që ka kushtëzuar edhe sjelljen e re konsumatore, por edhe si rezultat i trysnisë në rritje të penetrimit të teknologjisë në industrinë financiare. Ndryshime të rëndësishme në modelin e biznesit të bankave në tregun lokal do të mund të realizohen në përputhje me shpejtësinë dhe shkallën e penetrimit të shërbimeve bankare online, nga ana e klientëve. Kjo nuk është vetëm një çështje që ka lidhje me zhvillimet teknologjike, por edhe me sjelljen konsumatore në drejtim të përdorimit të kanaleve alternative.

Cilët sektorë apo segmente të kredituar prej jush janë prekur më shumë nga kriza ekonomike? A prisni përfaqësim në përmasa shqetësuese të cilësisë së portofolit të kredisë dhe, nëse po, kur mund të ndodhë kjo?

Rënia e nivelit të konsumit dhe investimeve individuale dhe familjare kanë ndikuar edhe në rënie të volumeve të tregtisë dhe të shërbimeve, që përbëjnë edhe shkakun kryesor që Prodhimi Kombëtar Bruto (PKB) shënoi nivele negative në vitin 2020. Sektorë të rëndësishëm të ndikuar nga kriza mbeten kryesisht tregtia (veçanërisht në segmentet e biznesit

të vogël dhe të mesëm), si dhe turizmi dhe shërbimet hoteliere, që janë shtylla të rëndësishme të ekonomisë lokale. Si rrjedhojë e një trendi të ngjashëm në ulje të volumeve të tregtisë në rajon dhe më gjerë, edhe shërbimet e transportit janë ndikuar negativisht nga kjo krizë. Kufizimet në lëvizshmërinë e njerëzve, referuar rregullave në fuqi, kryesisht nga shtetet e Komunitetit Europian, do të vijnë të përbëjnë një sfidë për turizmin, duke zvogëluar mundësinë që turistë të huaj të vizitojnë vendin tonë në sezonin e verës. Gjithsesi, fushata e vaksinimit vlerësojmë se do të sjellë përmirësim të situatës së pandemisë. Politika e mbajtjes hapur të kufijve do të mundësojë që turistë nga rajoni dhe më gjerë të mund të vizitojnë vendin tonë, duke i dhënë frymëmarrje ekonomisë sonë lokale dhe shërben si sinjal për rigjallërim të turizmit lokal. Nuk vlerësojmë se do të ketë rritje materiale, apo situata shqetësuese me portofolin e kredisë. Kufizimet aktuale, referuar kryesisht orës policore, nuk konsiderohen thelbësore për ekonominë lokale. Bazuar edhe në parashikimet nga institucione të ndryshme financiare ndërkombëtare, 2021 do të jetë vit kthesë me pritshmëri për PKB në nivele pozitive.

Cilat janë pritshmëritë dhe objektivat tuaja kryesore për ecurinë e biznesit në vitin 2021?

Tirana Bank vijon t'i përmbahet objektivit strategjik të rritjes së mëtejshme të aktivitetit, me një përfaqësim dinamik, por edhe të kujdesshme, në drejtim të mundësive për zhvillim, si dhe ndaj risqeve që karakterizojnë tregun lokal. Ne do të vijojmë të shfrytëzojmë praninë tonë të rrjetit të degëve të Bankës, për të vijuar rritjen natyrale organike, duke synuar zgjerim të mëtejshëm të bazës së klientëve dhe të depozituesve, sikurse edhe në dy vitet e fundit. Situata e shëndetshme e likuiditetit na ofron mundësinë për të zgjeruar portofolin e kreditimit për individët, për nevojat e tyre për kredi hipotekore dhe konsumatore, si dhe mbështetjen e sektorëve të ndryshëm dhe dinamikë të biznesit. Referuar strategjisë së zhvillimit, ne do të vlerësojmë edhe mundësitë që mund të paraqiten në periudhën afatshkurtër - afatmesme, si rezultat i procesit të konsolidimit në sektorin bankar/financiar, duke synuar zgjerim të pranisë sonë në tregun lokal. Gjithashtu jemi në procesin e marrjes së miratimeve përkatëse nga autoritetet rregullatore, për hapjen e Bankës sonë në Kosovë, si fillim nëpërmjet një zyre përfaqësimi. Tirana Bank do të mbetet një aktor i rëndësishëm i sektorit bankar dhe me orientim të qartë për të vijuar mbështetjen për zhvillimin e ekonomisë lokale. ■